

Taksa e fshehur: Pse kosovarët paguajnë më shumë?



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Taksa e fshehur: Pse kosovarët paguajnë më shumë?

Prishtinë, Janar 2013

E drejta autoriale © 2013 EFB/NEF dhe Instituti Demokraci për zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikave apo vlerësimeve, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar etj., pa lejen me shkrim të D4D-së.

Kërkimet për këtë projekt janë kryer nga Kastriot Jahaj; punimi është hartuar nga Dardan Sejdiu si dhe është redaktuar nga Drilon Gashi, Leon Malazogu dhe Shpend Emini. Instituti D4D është mirënjohës për të gjithë ata të cilët morën pjesë në këtë punim, duke përfshirë të intervistuarit, hulumtuesit dhe të gjithë kontribuuesit e tjerë.

Ky raport është përgatitur në kornizën e Programit Rajonal të Politikave „Think and Link“ i cili mbështetet nga European Fund for the Balkans (EFB). Një nismë e përbashkët e Robert Bosch Foundation, Compagnia di San Paolo, ERSTE Foundation dhe King Baudouin Foundation nga NEF. Përmbajtja e këtij raporti është krejtësisht përgjegjësi vetëm e Institutit Demokraci për zhvillim (D4D), dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si diçka që reflekton pozicionin e European Fund for the Balkans.

Përmbajtja

- Përmbledhje, 4
- Hyrje, 6
- Metodologjia e hulumtimit, 10
 - Faza 1: Një listë e gjerë e produkteve, 11*
 - Faza 2: Reduktimi i listës, 11*
 - Faza 3: Lista e shkurtër, 12*
 - Faza 4: Regjimet e importit (Politikat e importit), 13*
 - Faza 5: Lista përfundimtare e produkteve, 13*
- Dy produkte problematike, 14
 - Arkat fiskale, 14*
 - Çimentoja, 18*
- Sigurimi i konkurrencës në Kosovë, 23
- Përfundim, 25
 - Sjellja monopoliste – kontrolli i çmimit, 25*
 - Korrupsioni, 25*
 - Joefektshmëria e tregut, bizneseve dhe ato institucionale, 26*
- Rekomandime, 27
- Fusnota, 29

Përmbledhje

Ka dëshmi që shumë produkte kushtojnë dukshëm më shumë në Kosovë se sa në vendet fqinje. Çmimet më të larta shtrenjtojnë koston e jetesës për shumicën e kosovarëve. Si rezultat, indeksi i çmimeve të konsumit është rritur në mënyrë të vazhdueshme gjatë shtatë viteve të fundit. Fakti që sektorët e ekonomive familjare dhe të bizneseve varën shumë nga importet vetëm rritë presionin e çmimeve.

Ky punim analizon trendët e çmimeve të dy produkteve kryesore për të cilët konsumatori komercial i vendit paguan më shumë në krahasim më të tjerët në rajon. Gjetjet tregojnë se ka prani të madhe të joefektshmërive të tregut dhe praktikave për fryrje të çmimeve. Sektorë të veçantë të tregut janë të dominuara nga kompani private që kanë krijuar monopole duke ngritur barriera të hyrjes për konkurrent të ri.

Një shembull i qartë është sektori i arkave fiskale që paraqet dukuri monopoliste dhe joefektshmëri të biznesit dhe industrisë. Industria e çimentos është një rast tjetër në të cilën një shitës përdor pozitën e tij dominues në treg në mënyrë të padrejtë. Këto fenomene shpjen një dyshim të fortë për korrupsion. Çmimi më i lartë për kompani në treg nënkupton çmime më të mëdha për kosovarët e rëndomtë.

Në lidhje me këto dy produkte, ka tregues të mjaftueshëm të joefektshmërive institucionale sikur mungesa e legjislacionit dhe të kompetencës nga autoritetet përgjegjëse për inspektimin dhe rregullimin e tregut.

Institucionet relevante të Kosovës nuk kanë bërë mjaft për të mbrojtur tregun nga praktikrat e padrejta të tregut. Hulumtimi tregon se këto praktika të tregut janë rezultat i politikave joadekuate dhe vendimeve të tjera të institucioneve.

Një ekonomi e tregut me konkurrencë të lirë është njëra nga dispozitat bazike e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe është njëra nga kriteret kryesore për anëtarësim në BE. Megjithatë, mekanizmat e tanishme të kontrollit kanë qenë joefikase në sigurimin e mbrojtësve të tregut. Këto mekanizma sfidohen në vazhdimësi nga niveli i lartë i kontrabandës, krimi i organizuar, institucionet jo të efektshme të rregullimit të tregut dhe nga ajo që mund të jetë korrupsion.

Ende ka sfida për të garantuar masa mbrojtëse të mjaftueshme për një mjedis të tregut i cili është i lirë dhe i drejtë. Përveç praktikave jo të drejta të tregut, sigurimi i masave të mjaftueshme mbrojtëse dhe të matshme të blerësit mbetet sfidë, në veçanti për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës.

Rrjedhimisht zbatimi i Ligjit mbi Konkurrencën është i pamjaftueshëm. Në përputhje me rekomandimet e këtij punimi, autoriteti i konkurrencës dhe institucionet e tjera relevante duhet të marrin pushtetin e nevojshëm për të vepruar në mënyrë sistematike dhe për të përmbushur misionet e tyre.

Kosova nuk mund të prosperoj pa një ekonomi të rregullt tregu. Nga ana tjetër, ekonomia e tregut nuk mund të themelohet në mënyrë të mirëfilltë pa rregullimin e mjedisit ekonomik. Ky mjedis duhet të ketë institucione dhe autoritete kompetente të cilët sigurojnë konkurrencë të lirë dhe të drejtë. Mjedisin nuk mund të krijohet pa zbatimin e mjaftueshëm të rregulloreve ekzistuese, dhe pa zhvillimin e mëtejshëm të kornizës së tanishme ligjore. Më hollësisht, ka nevojë të menjëhershme për strategji për luftimin e kontrabandës dhe të gjitha llojeve të tregtisë së paligjshme.

Hyrje

Ky punim sjellë dëshmi të re që hedhë dritë mbi rritjet artificiale të çmimeve të produkteve esenciale në Kosovë. Përveç paraqitjes së shpjegimit të arsyeve që shpien në çmime më të larta, ky punim ka për qëllim që të ndikojë tek politikë-bërësit dhe t'i shtyjë ata për të marrë veprime korigjuese.

Brenda kornizës së Programit Rajonal të Politikave „Think and Link“, Instituti Demokraci për zhvillim ka bërë një studim për të identifikuar taksën e fshehur dhe potencialin për rritjen e fuqisë blerëse në Kosovë. Përmes një analize të çmimeve të produkteve të veçanta në vend dhe në rajon, ky punim ka synuar të vlerësoj dukuritë e kontrollimit të çmimit dhe të praktikave të tjera të dyshimta në treg.

Niveli i varfërisë në Kosovë mbetet i lartë me 34.5% të popullatës në varfëri të përgjithshme.¹ Papunësia zyrtare raportohet të jetë përafërsisht 37%.² Së bashku me faktin që më shumë se 70% të importeve janë artikuj të qarkullimit të shpejtë³, konsumatorët në vend duhet të paguajnë shumë më shumë se ata në rajon⁴.

Bilanci neto tregtar vazhdon të ketë deficit të lartë për shkak të nivelit të ulët të prodhimit vendor, dhe Kosova vazhdon të importoj shumicën e artikujve shpenzues. Siç prezantohet në figurën e mëposhtme, në periudhën njëvjeçare deri me shtator 2012 bilanci neto tregtar ka vazhduar të rritet—janë rritur importet gjithsej dhe janë ulur eksportet.

Rezultat i kësaj është një indeks i çmimeve të konsumit (IÇK) me trend të rritjes për më shumë se shtatë vjet. Ushqimi dhe pijet joalkoolike përbejnë pjesën më të madhe të IÇK-së, të pasuar nga transporti, veshjet dhe këpucët, strehimi, uji, rryma dhe artikuj shpenzues.

Figura 1: Eksportet dhe importet për shtator 2011 dhe 2012⁵





Figura 2: Zhvillimi i indeksit të çmimeve të konsumit 2003 - 2011 (tetor 2012)⁶



Në një mjedis ekonomik ku shumica e artikujve shpenzues janë të importuara, analizimi i formimit dhe caktimit të çmimit nuk mund të jetë i plotë pa një analizë të mirëfilltë krahasuese me ekonomi të ngjashme. Për qëllimet tona, të dhënat u krahasuan me Shqipërinë, Serbinë dhe

Maqedoninë. Përzgjedhja e produkteve u përqendrua në ato të cilët janë të importuara në ekonominë rajonale, duke lejuar që vetëm taksat dhe tagrat e doganës të përbejnë dallimin e çmimeve.

Sektorë të veçantë në treg duken të jenë të dominuara nga kompani të sektorit privat. Dyshohet se ato kanë krijuar monopole duke ngritur barriera të larta të hyrjes ndaj konkurrentëve të ri. Një shembull ilustrues në Kosovë është industria e arkave fiskale, siç shpjegohet më vonë në këtë punim.

Marrëveshje për kontrollimin e çmimit duken të jenë të pranishme në industri të caktuara ku lojtarët ekzistues në fakt pamundësojnë potencialin për konkurrencë. Pa një konkurrencë të lirë, garuesit marrin fitim të padrejtë duke i rritur çmimet që pastaj duhet t'i bartë konsumatori kosovar.

Shkaqe të tjera të inflacionit të çmimeve kanë të bëjë me klimën e pafavorshme të biznesit. Kjo shkon nga qasja e kufizuar e bizneseve për financim, që për fat të keq dikton një kosto më të lartë të huamarrjes, deri në gjyqësorin e dyshimtë dhe mekanizma joefektive të zbatimit të vendimeve gjyqësore. Tregu i arkave fiskale është edhe një shembull i këtij fenomeni, kurse klima e pafavorshme e biznesit ndikon tek të gjitha bizneset.

Synimi i hulumtimit tonë është ta identifikojmë shkakun e vërtetë që shpjegon pse çmimit për shfrytëzuesin e fundit janë më të larta në Kosovë se sa në rajon. Duke pasur parasysh shkallën e kufizuar të këtij projekti, D4D ka vendosur që ishte metodologjikisht adekuat përzgjedhja e dy produkte nga të cilët shihet i gjithë cikli, nga importimi deri në shitje.

Qëllimi është për të ndarë elementët kryesore potenciale që ndikojnë tek praktikat e fryrjes së çmimeve në vend.

Studimi fillimisht krahason çmimit e mallrave të caktuara në Kosovë me ato në vendet e rajonit. Pasi të ofrohet një dëshmi e çmimeve më të larta në vend, hulumtimi ka bërë një analizë të detajuar të produkteve të identifikuar nga të cilët vërehet së çmimi i tyre është qartazi më i lartë se sa në rajon, dhe ku nuk ka ndonjë arsyeje racionale ekonomike për këtë. Bazuar në analizën tonë, këto dallime në mes të çmimeve nuk vijnë nga taksat më të larta apo nga tarifat që bartë importuesi, apo nga ndonjë subvencion që ka prodhuesi eksportues.

Metodologjia e hulumtimit

Për të kuptuar mekanizmin e caktimit të çmimeve dhe për t'i krahasuar çmimet e produkteve të caktuara në Kosovë me ato në rajon, u nevojiti një studim i detajuar i forcave që krijojnë çmimet dhe tregun. Për këtë qëllim studimi është ndarë në disa faza.

Të dhënat të cilët u përdorën për këtë hulumtim u mbledhën nga intervista, një skenim i çmimeve të shitjes me pakicë dhe nga burime të të dhënave zyrtare. Ka qenë me rëndësi që këto të dhëna të mblidhen nga të gjithë aktorët relevantë që analiza të përmbajë caktimin e çmimeve dhe që të kuptohen më mirë shtytësit e tregut dhe sjellja e aktorëve kryesor. Agregimi dhe analiza e të dhënave kryesore siguruan një qasje objektive për t'i kuptuar praktikatat e kontrollimit të çmimeve në treg.

Për shkak të ndjeshmërisë së çështjes, D4D nuk ka mundur të identifikojë dhe zbërthejë të gjitha të dhënat. Pas kësaj metodologjia të hulumtimit, përfundimet u nxorën nga studimi i dy produkteve të përzgjedhur. Këto pastaj mund të përdorën si shembuj të trendëve të pritshme të inflacionit të çmimeve në shumë sektorë të tjerë.

Metodologjia e hulumtimit ka parashikuar përzgjedhjen e shumë produkteve, të cilëve ju janë krahasuar çmimet dhe formimet e çmimeve me çmimet e produkteve të njëjta në vendet në rajon. Procesi i përzgjedhjes së pari ka filluar me listë të gjerë të produkteve i cili u përdor për t'i krahasuar produktet dhe çmimet.

Në fund, dy produkte janë identifikuar si të përshtatshme për t'i ilustruar parregullsitë e çmimeve dhe të tregjeve. U vlerësua më shumë shpjegimi i dy produkteve se sa një argumentim jo aq i dokumentuar për një numër më të madh të produkteve.

Faza 1: Një listë e gjerë e produkteve

Pika fillestare e hulumtimit tonë ishte një analizë e shportës konsumuese në të gjitha vendet e përzgjedhura. Lista ka përmbledhur produkte esenciale dhe të standardizuara nga shumë kategori duke përfshirë ushqimin, strehimin, shëndetësinë dhe transportin. Ajo përfshin produkte dhe shërbime nga ujësjellësi dhe rryma, deri tek produktet e ushqimit sikur buka, mishi dhe vezët dhe produkte të tjerë si vaj ushqimor, arkat fiskale dhe produktet farmaceutike.

Faza 2: Reduktimi i listës

Shumë kritere u caktuan për të siguruar një krahasim të rregullt në mes të produkteve, dhe për të ngushtuar listën e produkteve potenciale për të cilët nevojitej hulumtim dhe krahasim. Pika fillestare ishte shporta e konsumit për familje, e cila u përdor për dy kritere shtesë:

- ⇒ Për të siguruar që produktet e identifikuar ishin esenciale dhe të rëndësishme.⁷
- ⇒ Për të siguruar që produktet që ishin më të standardizuara dhe të importuara në shumicën nëse jo në të gjitha shtetet e rajonit që u përdorën për të bërë krahasime.

Kjo fazë ka përfshi hulumtim paraprak të një liste më të gjerë të produkteve. Pastaj ka vijuar kategorizimi i produkteve, dhe dallimi i të importuarve si bazë e analizës. Gjithashtu, një përzgjedhje e produkteve me çmime më të larta u vendos për të ngushtuar më shumë listën e produkteve.

Informata shtesë janë përmbledhur nëse janë parë si të rëndësishme për procesin e përzgjedhjes. Informata u morën nga importuesit, dhe nga agjencitë rregullative të qeverisë që kanë qenë të përfshirë në kontrollimin dhe

licencimin e produkteve të importuara dhe kompanive përkatëse.

Duhet të theksohet se një bazë e gjerë e bizneseve u intervistuan për të arritur një kuptim më të thellë të dinamikave të tregut. Regjimet rajonale të doganës, tarifave, dhe procedurat për të tregtuar një produkt u hulumtuan gjithashtu. Ishte esenciale të saktësohen të gjitha shtesat në çmimin e importit për të vlerësuar saktësisht marzhën e fitimit, dhe të hulumtohet nëse kjo marzhë ishte tepër e lartë në Kosovë.

Këto hapa ngushtuan listën në 14-15 produkte në kategoritë kryesore. Hulumtime të mëtejme mblodhën informata të çmimeve për produktet e mbetura në tre shtetet e rajonit.

Faza 3: Lista e shkurtër

Për të konfirmuar që procesi i përzgjedhjes së produkteve ishte i saktë, ne kemi bërë hulumtime shtesë të terrenit për të gjithë produktet e caktuara. Kriteret kryesore të hulumtimit për krijimin e listës së shkurtër ishin që:

- ⇒ Produkti të jetë i standardizuar dhe i krahasueshëm;
- ⇒ Grumbullimi dhe verifikimi i çmimit në së paku tre pika të shitjes në të gjitha vendet e përzgjedhura;
- ⇒ Çmimet për njësi tek shitjet për pakicë në treg shërbyen si krahasues, duke analizuar sa paguan konsumatori për të marrë produktin;
- ⇒ Për më shumë, duke bërë verifikimin e çmimit në të njëjtët data në të gjitha shtetet e hulumtuara, procesi siguroj një krahasim të rregullt, relevant dhe të ngjashëm.

Aspekte të tjera të hulumtimit në këtë fazë kanë përfshirë: politikën e importit (doganat, taksa e akcizës, tarifave), efektivitetin e ndërmarrjeve dhe dinamikën e tregut me një

përqendrim të veçantë në barriera të mundshme të tregut që kanë mundur të krijojnë monopole në treg.

Faza 4: Regjimet e importit (Politikat e importit)

Hulumtimi krahasoj tagrat doganore dhe të akcizës për të gjitha vendet dhe dallimet në mes tyre për të bërë një krahasim empirik. Analiza u mbështet në taksat e importit të aplikuara në Kosovë, duke kufizuar listën e produkteve të krahasueshme.

Kjo analizë qartësoi nëse dallimet e çmimeve ishin për shkak të regjimeve të importit apo që këto taksa kishin ndikim të ngjashëm në caktimin e çmimit të produkteve në të gjitha vendet e hulumtuara. Sipas kritereve tona, çmimet përfundimtare ishin të krahasueshme kur efektet e taksave dhe regjimeve të importit ishin të ngjashme në secilin vend.

Faza 5: Lista përfundimtare e produkteve

Në këtë fazë, dallimet në mes të çmimeve nuk kanë mundur të shpjegohen nga tagrat e importit dhe kjo ka shpie një analizë në dy fronte:

- ⇒ Efektiviteti i ndërmarrjeve, dhe;
- ⇒ Fryrja e çmimeve dhe sjellja monopoliste e ndërmarrjeve në treg për produkte të caktuara.

Ky hulumtim gjithashtu analizoi produktet farmaceutike por ato nuk janë përfshirë në prezantimin final. Për shkak të kërkesave të ndryshme rregullative të vendeve të përzgjedhur—që kishin të bëjnë me caktimin e çmimit të barnave—ishte vështirë që të nxirën krahasime dhe shkakun e çmimeve më të larta në Kosovë.

Kjo analizë u mbështet mbi faktin që ekonomitë e krahasuara janë pothuajse të të njëjtës madhësi, dhe nuk ka dispozita ligjore apo rregullative të cilët do të kishin ndonjë efekt mbi çmimet e produkteve.

Dy produkte problematike

Procesi i përzgjedhjes siç u përshkrua më sipër rezultojë në përzgjedhjen e dy produkteve në vijim: arkat fiskale dhe çimentoja. Vetëm këto dy produkte përbushën shumicën nëse jo të gjitha kriteret e parapërcaktuara që lejuan për një metodologji adekuate për krahasim.

Arkat fiskale

Në 2009 Qeveria e Kosovës ka paraqitur nevojën që bizneset të pajisen me arka fiskale për të minimizuar apo për të përjashtuar krejtësisht evazionin tatimor. Prapëseprapë, evazionin fiskal është ende i pranishëm, dhe procesi i integrimet të arkave fiskale vetëm se i ka dobësuar bizneset e vogla. Për më shumë, përmes këtij procesi, bizneset e vogla dhe të mesme kanë paguar më shumë se 20 milion euro që nga viti 2009 vetëm për instalimin e arkave fiskale.⁸

Në mënyrë që ta zbatoj këtë politikë, Qeveria e Kosovës fillimisht ka shpallur një tender publik për arkat fiskale. Rezultati përfundimtar i procesit të tenderimit ishte licencimi i dy kompanive, Dukagjini SH.P.K. dhe Gekos SH.P.K., për shitjen, instalimin dhe mirëmbajtjen e arkave fiskale. Megjithatë, asnjëra nga këto kompani të përzgjedhura nuk kishin ndonjë përvojë të mëhershme në shitjen apo në mirëmbajtjen e pajisjeve të tilla para se të fitonin tenderin⁹. Përveç fitimit nëpërmjet çmimit të shitjes, këta furnizues të arkave fiskale do t'i kërkonin bizneseve një pagesë vjetore të mirëmbajtjes.


Këto dy kompani më vonë u gjobitën për praktikën e tyre jo të rregullta tregtare. Një hetim pasues në shtator të vitit 2010 nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK), një trup i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, zbuloi që kompanitë e përmendura më sipër kanë monopolizuar tregun. Si rezultat, AKK-ja u ka dhënë nga një gjobë prej 100,000 euro secilës kompani.¹⁰

Pavarësisht nga ky vendim, i cili nënvizoj që kompanitë të cilët ofronin arka fiskale në Kosovë kanë krijuar monopol, çmimi i arkave fiskale ka vazhduar të jetë joproportionalisht me i lartë në vend se sa në rajon.

Për arsyeje krahasuese, hulumtimi i këtij projekti përqendrohet në vetëm një lloj të arkës fiskale. Më hollësisht, arka fiskale e llojit MP-55Ej ishte ajo që u analizua. Çmimi i kësaj arke fiskale së bashku me pajisjet përcjellëse është 665 euro në Kosovë kurse çmimi i po këtij produkti është shumë më i ulët në vendet e rajonit. Grafika e mëposhtme prezanton këtë dallim të dukshëm në mes të çmimeve.

Figura 3: Çmimi i arkave fiskale – gjetjet e tregut nga D4D

Çmimi i arkave fiskale në shtetet e hulumtuara (në euro)



Duke iu referuar të dhënave zyrtare nga Doganat e Kosovës, ky produkt importohet nga Bullgaria me çmimin fiks prej 138 eurove. Në anën tjetër, shfrytëzuesit e fundit, ndërmarrjet dhe bizneset, duhet të paguajnë një çmim për të i cili është 4 herë e gjysmë më i shtrenjtë, pra 665 euro.

SH.P.K. „GEKOS“, kompania e parë e licencuar, u gjobit për një shumë prej 100,000 euro për shitjen e arkave fiskale dhe krijimin e monopoleve, si dhe për shfrytëzimin e pozitës së saj dominuese në tregun vendor. Njëlloj, kompania tjetër,

SH.P.K. „Dukagjini“, u gjobit gjithashtu për 100,000 euro për praktikat e koordinuara të cilët lejuan që SH.P.K. „GEKOS“ të krijoj monopol dhe të shfrytëzoj pozitën dominuese.

GEKOS kishte një qëndrim kontradiktor. Në njërën anë, GEKOS mori pjesë në praktika të koordinuara, krijoi dhe mbajti monopol. Njëkohësisht, ajo dërgoi letër rekomandimi tek Ministria e Ekonomisë dhe të Financave duke kërkuar liberalizim të tregut. Paradoksalisht, ajo kërkoi që komisioni licencues të analizojë të gjithë procesin e instalimit të arkave fiskale në Kosovë.

Pak pas vendimit të AKK-së, dy kompani shtesë fituan licenca nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për shitjen, instalimin dhe mirëmbajtjen e arkave fiskale. Mekanizmi licencues mundësoi një treg të mbyllur në të cilën vetëm një numër i kufizuar i kompanive u lejuan që të marrin pjesë.

Në krahasim, tregjet rajonale për arkat fiskale kanë shumë kompani të cilët ofrojnë arka fiskale dhe nuk kanë dominues të tregut. Shqipëria ka dhjetëra kompani të licencuara që shesin këtë produkt. Në Maqedoni, nuk ka nevojë fare një shitës të mbaj licencë për të shitur arka fiskale dhe ky produkt mund të gjendet në shumicën e dyqaneve me pajisje elektronike.

Edhe pas dy viteve që nga marrja e licencave, kompanitë „Printec“ dhe „R&T“ nuk kanë mundur të hyjnë në treg. Përparësia e hyrjes në treg i pari dhe barrierat e hyrjes të krijuara nga „GEKOS“ dhe „Dukagjini“ mundësoi që ata të mbajnë pozitë dominuese në treg. Kjo ishte pasojë e mbrojtjes së tregut nga politikat e vendosura prej qeverisë. Gjobat e pamjaftueshme që erdhën si rezultat e aktiviteteve të kompanive „GEKOS“ dhe „Dukagjini“ para se gjithash u shfrytëzuan si “qira” për ta mbajtur status quo-n, dhe për të krijuar një sipërfaqe të realitetit. Prodhuesit paguan gjobat e ulëta për të vazhduar kontrollimin e tregut.

Problemi në Kosovë vjen nga fakti se qysh në fillim licenca për të operuar në këtë treg u është dhënë vetëm dy kompanive, dhe këto kompani më pastaj filluan t'i koordinojnë aktivitetet. Sipas informatave nga Oda Amerikane në Kosovë, në kohën kur operatorët e tjerë filluan të marrin licenca, më shumë se 90% e pjesëmarrjes në treg ishte mbuluar. Kur blerësit nuk e kanë mundësinë e zgjedhjes, mundësia për të krijuar monopol dhe për t'i fryrë çmimet është shumë e lartë. Për më shumë, kur të instalohen arkat fiskale në më shumë se 90% të tregut, barrierat e hyrjes bëhen shumë të larta, rrjedhimisht duke shtuar koston e hyrjes në treg.¹¹

Gati padyshim mund të thuhet se ka sjellje monopoliste në tregun vendor për arka fiskale. Duke pasur parasysh përparësinë që gëzojnë konkurrentët e parë në treg, kompanitë që u licencuan më vonë nuk kanë mundur të tejkalojnë barrierat e hyrjes të kompanive të para, të cilat—përtej përparësisë së hyrjes në treg i pari—gjithashtu kanë koordinuar praktikat e tyre.

Si përfundim, tregu dominohet nga të dy konkurrentët e parë, të cilët tashmë kanë më shumë se 90% të pjesëmarrjes në tregun e arkave fiskale. Meqenëse shumicën e fitimit e bëjnë nga mirëmbajtja, kjo kufizon potencialin e futjes në treg për kompani të tjerë. Këtyre dy kompanive i është dhënë hapësirë e mjaftueshme nga politikat e zgjedhura nga qeveria dhe kanë siguruar që mund të paguajnë gjrobat e monopolit të tregut, pra “qiranë”. Kjo hapësirë apo pushtet i këtyre kompanive është ruajtur përderisa politikat nuk kanë ndryshuar.

Çimentoja

Në të gjithë Ballkanin Perëndimor, çimentoja më e shtrenjtë është ajo në Kosovë. Arsyeja kryesore për këtë është që vendet fqinje kanë tregje më të liberalizuara në të cilat konkurrenca funksionin relativisht mirë.

Se fundmi, një taksë mbi çimenton e importuar është vendosur në Kosovë sipas Ligjit për Masat Mbrojtëse në Importe.¹² Kjo është imponuar si një masë mbrojtëse ndaj çimentos së importuar, në mbrojtje të prodhuesit vendor. Kjo politikë e imponoi një mekanizëm mbrojtës i cili rrjedhimisht destabilizoi tregun duke krijuar një monopol artificial për SharrCemin, një prodhues i çimentos nga Kosova. Argumenti kryesor nga qeveria ishte se këto barriera u ngritën për të mbrojtur dhe rregulluar ekonominë. Megjithatë barrierat kanë prodhuar të kundërtën e rezultateve të dëshiruara.

Fabrika e çimentos SharrCem është prodhuesi i vetëm i çimentos në vend. Në 2010 Agjencia Kosovare e Privatizimit, e cila udhëheq procesin e privatizimit, ka krijuar kompaninë NewCo „SharrCem“ e cila është fituar nga Titan Group për 30.1 milion euro. Përveç SharrCemit, Titan Group gjithashtu ka pronësinë mbi fabrika të tjera të çimentos në rajon, sikur me Cementarnica USJE AD në Shkup, Maqedoni, Fabrika e Çimentos Kosjaric në Serbi dhe ANTEA e Krujës së Shqipërisë.


Në rajon, Titan Group ka një konkurrent shumë të fortë në Fabrikën e Çimentos së Fushës së Krujës (FKCF), e cila ka dy fabrika, një në Elbasan dhe tjetrën në Fushë Krujë. Kjo e fundit është e pronësuar nga Group Seament e Libanit.

SharrCem nuk konsiderohet të jetë mjaftueshëm konkurruese për shkak të infrastrukturës së saj të vjetër dhe sipas Titan Group, për shkak të kontratës jo shumë të favorshme të privatizimit në të cilën ka hyrë. Për më shumë, një çështje kyçe e kontratës, siç u shpjegua nga Titan në intervista, ishte se numri i punëtorëve është dashur të ruhej në nivelin e njëjtë për tre vitet e ardhshëm përderisa kompani njëkohësisht po humbiste pjesëmarrjen në treg.¹³

Për më tepër, autostrada kombëtare që po ndërtohet në Kosovë hapi mundësinë për FKCF-në, prodhuesin e

çimentos nga Shqipëria, të depërtojë më shumë në tregun e Kosovës. FKCF ka bërë këtë në pjesën perëndimore e Kosovës, ku ka shtuar dukshëm pjesëmarrjen në treg gjatë vitit 2011. Të dhënat për importet e çimentos nga Shqipëria dhe zhvillimi i tyre janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Figura 4: Importet e çimentos nga FKCF Shqipëria - Doganat e Kosovës



Importi i çimentos nga Shqipëria kishte një rritje dramatike në 2011 dhe gjetjet tona të hulumtimit tregojnë se ky trend ka vazhduar në 2012. Në 2009 FKCF kishte vetëm 3.2% të pjesëmarrjes në tregun e çimentos së Kosovës ndërsa në 2011 ajo arriti 21.1% të pjesëmarrjes në treg.


Rritja e pjesëmarrjes në treg nga FKCF ishte kryesisht për shkak të cilësisë së saj më të larë dhe çmimit të saj shumë të ulët prej 12 euro për ton krahasuar me çmimin e SharrCem të prej 65-71 euro për ton.

Për t'ju qasur kësaj situate të tregut, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë u pajtua që të përmbushë kërkesën e SharrCemit për të ndërhyrë në treg. Ministria zbatoi masa të përkohshme mbrojtëse të tregut duke mbrojtur SharrCemin si prodhues vendor. Masa të përkohshme mbrojtëse në gjithë importin e çimentos, me një taksë prej 35% për një

periudhë të 90 ditëve siç përcaktohet në ligjin për masat mbrojtëse në importe.

Pasoja e kësaj mase qeveritare paraqitet grafikisht më poshtë, duke përshkruar pjesëmarrjen në tregun e çimentos në qershor të vitit 2012. Të dhënat tregojnë se Titan Group (SharrCem dhe Titan Skopje) shtoi pjesëmarrjen në tregun e çimentos së Kosovës deri në 65% për shkak të kësaj ndërhyrjeje.

Figura 5: Pjesëmarrja në tregun e çimentos në Kosovë (qershor 2012)¹⁴




Duke shfrytëzuar zbatimin e masave mbrojtëse, SharrCem shtoi çmimin e saj për 21%, duke ngritur çmimin në 94 euro për ton. Pasojat e këtij vendimi ndikuan në treg, duke përfshirë çmimin, cilësinë dhe mundësinë për blerësin të zgjedhë në mes të alternativave. Ndërkohe cilësia e çimentos së FKCF ishte dukshëm më e mirë, dhe kishte çmimin më të lirë. Vendimi krijoi një situatë të cilën e shfrytëzoi SharrCem për të keqpërdorur pozitën e saj në treg. Në fund, mekanizmi mbrojtës i qeverisë rezultoi në produkte më të shtrenjta por me cilësi më të ulët për konsumatorët.

Me përcaktimin e barrierave ekonomike, dy marrëveshje u shkelën: Marrëveshje e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) dhe marrëveshja dypalëshe ekonomike në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. Hapa të tilla normalisht nuk ndërmerren nga shtete të cilat kanë marrëdhënie të mira dypalëshe, sikur ato në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Vendimi u sfidua edhe nga zyra e Bashkimit European në Kosovë për shkak se ishte në kundërshtim me CEFTA-n.¹⁵

Figura 6: Çmimi i çimentos – gjetjet e tregut nga D4D

Çmimet e një thesi 50 kg të çimentos në shtetet e hulumtuara (në euro)



Intervista private me shumë punëtorë të SharrCemit tregojnë për mungesa të cilësisë dhe parregullsi të tjera.¹⁶ Krahasimi i çmimeve në rajon të të njëjtit produkt për shitje me pakicë (50 kg të një thesi të çimentos) qartazi shfaqë çmimin më të lartë në tregun e Kosovës. Ky çmim është 19% më shumë se sa ai në Shqipëri, 13% më shumë se çmimi në Maqedoni dhe 9% më shumë se sa paguan shfrytëzuesi i fundit në Serbi. Më e lira nga katër shtetet në fjalë ishte Shqipëria, dhe kjo e fundit kishte çmimin afër 10% më pak se sa mesatarja e çmimit mes këtyre shteteve.

Vihet re se ka shumë faktorë të cilët kishin ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e çmimit përfundimtar në

tregun vendor të çimentos. Së pari, SharrCem-i nuk ka mundur t'i bëjë konkurrencë çmimeve të çimentos—siç u nënvizua nga menaxhmenti—për shkak të numrit të tepërt të punëtorëve, teknologjisë së vjetër dhe qymyrit të shtrenjtë të importuar.

Sipas AKK-së, vendimi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për t'i ndihmuar prodhuesit vendor duke vendosur masa të përkohshme mbrojtëse në importin e çimentos krijoi çrregullime në tregun vendor. Siç u tha nga përfaqësuesit e këtij autoriteti, AKK-ja do të bëjë një hetim më të mirëfilltë të industrisë së çimentos sepse të dhënat e mëhershme kanë treguar se SharrCem-i vazhdon të mbajë një pozitë dominuese në treg.¹⁷ Ky zotim erdhi pasi D4D u rikujtoi anomali të krijuara në treg.

AKK-ja besoj se vendimi për masat e përkohshme mbrojtëse forcuan pozitën e SharrCem-it si kompania dominuese në industrinë e çimentos. Si rezultat, masa mbrojtëse e ngritur ka rritur çmimin e një produkti më cilësi më të ulët, duke lejuar prodhuesin që të mbajë një pozitë dominuese në treg në mënyrë të paligjshme.¹⁸

Konsumatori apo shfrytëzuesi i fundit në vend duhet të bartë peshën e një çmimi 10% më të lartë se sa çmimi mesatar të katër shteteve të hulumtuara që shisin 50 kg të çimentos.

Sigurimi i konkurrencës në Kosovë

Konsumatori mesatar i Kosovës mbetet i pambrojtur dhe bartë barrën e garës së padrejtë të tregut. Një numër relativisht i madh i produkteve esenciale dhe që ndikojnë drejtpërdrejt në buxhetin e konsumatorit janë joproportionalisht më të shtrenjta se në rajon, gjë që ka motivuar kë hulumtim.

Ligji mbi Konkurrencën kërkon që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës të vëzhgoj tregun dhe të siguroj një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë së tregut. Për fat të keq, deri me tani autoritetet kanë bërë shumë pak për të arritur këtë. Sipas AKK-së, atyre u mungon kapaciteti dhe kjo bën që të mos arrihet shumë. Për shembull, autoriteti merr shumicën e të dhënave të tij nga mediat dhe nuk ka kapacitet për ta inspektuar tregun dhe të mbledhë të dhëna të besueshme në mënyrë të pavarur.¹⁹

AKK-ja duhet të identifikojë dhe të luftojë çfarëdo marrëveshjeje sekrete apo jo të rregullt në mes të kompanive e cila rezulton në çmime më të larta. Ajo duhet të veproj në mënyrë proaktive për të siguruar konkurrencë të lirë dhe të drejtë. Deri me tani ky institucion ka dështuar në përmbushjen e misionit të tij.

Duke iu referuar Ligjit mbi Konkurrencën, AKK-ja ka përgjegjësinë dhe autoritetin për zbatimin e ligjit, promovimin e konkurrencës në mes të ndërmarrjeve dhe mbrojtjen e konsumatorëve në Kosovë. Si rrjedhojë, AKK-ja duhet t'i parandaloj veprimet që kufizojnë, shtypin apo çrregullojnë konkurrencën e tregut.

Ligji përshkruan konkurrencë të lirë dhe efektiv në treg, bazuar në tre shtyllat kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës së tregut nga:

⇒ Keqpërdorimi i pozitës dominuese;

- ⇒ Marrëveshje të ndalura në formën e karteleve, dhe;
- ⇒ Bashkimet dhe përqendrimet e ndërmarrjeve.²⁰

Konkurrenca është një komponent kryesor i një ekonomie të zhvilluar të tregut. AKK-ja duhet të funksionoj si një shtytës dhe një përkrahës i konkurrencës. Ajo duhet të mbroj interesat e konsumatorëve dhe kompanive me qëllimin përfundimtar të një tregu të lirë dhe të rregulluar.

Nuk ka ekonomi të tregut dhe konkurrencë të lirë në sektorët e përzgjedhur në këtë punim. Duke iu referuar analizës dhe intervistave tona, konsumatorë të Kosovës përballën me çmime më të larta se sa vendet në rajon edhe kur bie fjala tek produktet për të cilat lypset hulumtim shtesë në të ardhmen.

Çmimet që janë paarsyeshëm më të larta të arkave fiskale, si dhe çrregullimet e pajustificuara të tregut—për shkak të ndërhyrjes shtetërore—siç shpjegohet në analizën e industrisë së çimentos, tregojnë se AKK-ja ka dështuar të përmbushin objektivat dhe përgjegjësitë e tyre. Së bashku me mungesën e kapacitetit institucional, ekonomia politike dhe korrupsionin i mundshëm shtetëror janë arsyet kryesore për dështimin e AKK-ës.

Përfundim

Sjellja monopoliste – kontrolli i çmimit

Dukuria e monopoleve artificiale duket të jetë një ndër shtytësit kryesor të çmimeve më të larta në tregun kosovar. Gjetjet nga arkat fiskale, në veçanti, përbejnë një bazë të mjaftueshme për të arritur tek ky përfundim. Për më shumë, kur monopoli është arsyeja prapa dallimeve në çmim, niveli i çmimit është edhe më i lartë.

Marrëveshjet e fshehta, kontrollimi i çmimit dhe praktika të tjera të koordinuara në mes të kompanive dukën të jenë të pranishme, sidomos në analizimin e aktorëve në biznesin e arkave fiskale. Në anën tjetër, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nuk ka mundur të kanalizoj dhe luftoj këto praktika, edhe pse ka konfirmuar që ato ekzistojnë. Lehtësisht mund të argumentohet që ky dështim ka shtuar më shumë joefektshmërinë e tregut dhe ka çrregulluar tregjet përkatëse.

Korrupsioni

Deri në masën që ky lloj i hulumtimit mund të dalloj praktika joligjore, është vështirë të identifikohet korrupsioni në shkallë të mjaftueshme të sigurisë.

Megjithatë fenomenet që ne dallojmë mund të shërbejnë si dëshmi e mjaftueshme që autoritetet duhet të hapin procese hetimi për të nxjerrë të dhënat që nuk na u lejuan, apo që është dashur t'i marrim anonimisht.

Korrupsioni është shkak i mundshëm—edhe pse nuk dëshmohet këtu—prapa joefektshmërive të tregut që ne vërtetojmë në mënyrë të qartë. Situata e tregut në të dy industritë e interesit nënvizojnë mungesën e angazhimit të autoriteteve kompetente dhe të rregullatorëve. Joefektshmëritë institucionale mund, në mos më shumë,

krijojnë perceptimin e dukurisë së korrupsionit që pastaj ndikon tek praktikat për fryrje të çmimeve.

Padyshim sjellje të vazhdueshme monopoliste dhe marrëveshje për kontrollimin e çmimeve në treg janë tregues të fortë që sjellja korruptive mund të jetë pjesë e ekuacionit. Gjithashtu, punimi ynë ka listuar që të dy industritë kanë aktorë të cilët mbajnë pozitë dominues në treg për shkak të politikave të përzgjedhura të autoriteteve qeverisë.

Joefektshmëria e tregut, bizneseve dhe ato institucionale

Shkaku i vërtetë i çmimeve të larta të produkteve dhe të mungesës së konkurrencës në treg duken të jenë joefektshmëritë e tregut, e në veçanti mungesa e përfshirjes institucionale në mbrojtjen e ekonomisë së tregut. Megjithatë, janë në fakt po këto institucione të cilët kanë krijuar çrregullime të tregut.

Institucioni përgjegjës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ka dështuar në vëzhgimin e tregut dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë së tregut. AKK-ja ka dështuar të përballët në mënyrë të vazhdueshme me marrëveshjet e fshehta në mes të kompanive të cilët kanë shkaktuar çmime më të larta.

Ngjashëm, AKK-ja nuk ka arritur të siguroj funksionimin e rregullt të tregut duke sjellë dënime që janë të mjaftueshme dhe që në fakt përdorën si pagesë qiraje nga operatorët në treg. Prodhuesit paguajnë gjopa të ulëta për të vazhduar dominimin e tregut. Shuma e gjobave është shumë e ulët krahasuar me përfitimet që ata marrin nga pozicioni i tyre i privilegjuar.

Në anën tjetër, rasti i industrisë së çimentos tregon se joefektshmëritë e tregut dhe të bizneseve, së bashku me

ndërhyrjen qeveritare pa masa të mjaftueshme të kontrollit, mund të kenë një efekt substancial në treg. Mund të ndikojnë të çmimi dhe cilësia e produktit të ofruar.

Rekomandime

Rekomandimet në vijim janë esenciale për zhvillimin e një ekonomie të tregut me konkurrencë të lirë dhe të drejtë ku konsumatorët janë të mbrojtur, qofshin ata në anën e shitjes me pakicë apo biznesit.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe institucionet dhe komisionet përkatëse që kanë përgjegjësinë e mbikëqyrjes se industrive dhe garës duhet të fillojnë të veprojnë në mënyrë sistematike për të përmbushur misionet e tyre. Megjithëse mund të ketë nevojë për rregullim të mëtutjeshëm dhe infrastrukturë ligjore për t'i eliminuar joefektshmëritë, rregullat dhe ligjet e tanishme duhet të zbatohen në praktikë.

Vetëm duke i zbatuar ligjet dhe rregullat në fuqi mund të rregullojmë mjedisin ekonomik dhe të kemi institucione dhe autoritete kompetente. Kjo mund të lejoj zhvillimin substancial të ekonomisë së tregut dhe të themeloj një frymë të konkurrencës së lirë dhe të drejtë.

Prandaj AKK-ja së pari duhet të bëjë shtytje për krijimin e mekanizmave që mundësojnë që ajo të ndërhyjë dhe të rregulloj, kur praktikrat që pengojnë funksionimin e rregullt dhe efikas identifikohen dhe dëshmohen.

Veç kësaj, hapësirat legjislative duhet të mbyllën dhe të adresohen nga aktorët përkatëse, si nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, shoqata e biznesit si dhe nga organizatat për mbrojtjen e konsumatorëve. Hapësirat legjislative përfshin por edhe shkojnë përtej rregullat e zbatimit që ka në dispozicion AKK-ja. Hapësirat gjithashtu kanë të bëjnë me lidhjet në mes të të gjithë aktorët relevantë institucional,

gjykatat, ministritë, prokuroritë si dhe AKK-ja, dhe kriteret për mbrojtjen e tregut.

Çfarëdo vendimi për ndërhyrjen në treg duhet të bëhet përmes një procesi që siguron përfshirjen e shumë aktorëve, në vend që kjo t'ju lihet diskrecionit të një entiteti të vetëm. Rekomandohet që një mekanizëm verifikues të Kuvendit të Kosovës apo të njëjës nga komisioneve të saja të themeloj masa mbrojtëse.

Shoqatat e biznesit duhet gjithashtu të bashkëpunojnë me AKK-në dhe Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë për të siguruar që çfarëdo çrregullimi i tregut të vërehet dhe që dyshimet të shqyrtohen përmes një mekanizmi kredibil. Një mekanizëm i tillë duhet të siguroj komunikim të rregullt në mes të shoqatave, Ministrisë dhe AKK-së.

Fusnota

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Ballina. Indikatorët social. Në dispozicion në: <http://esk.rks-gov.net//>.

² Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Raport Vjetor 2011. Puna dhe Punësimi, fq. 9. Në dispozicion në: <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Librat/2011%20Raporti%20Vjetor%20Puna%20dhe%20Punesimi.pdf> (qasur për herë të fundit me 22 Janar 2013).

³ Këto artikuj të qarkullimit të shpejtë përfshin produkte që shitën shpejtë dhe me një çmim relativisht të lirë. Shembuj përfshin mallra jo të qëndrueshme si gjera ushqimore.

⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Shtator 2012. Statistikat ekonomike: Statistikat e tregtisë së jashtme, fq. 10. Në dispozicion në: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/14-tregtia-e-jashtme/97-statistikat-e-tregetise-se-jashtme-2012. Duke iu referuar raportit, më shumë se 70% të importeve janë artikuj të qarkullimit të shpejtë: (21.6%) produkte minerale, (12.3%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (10.9%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (10.3%) makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, (6.9%) produkte të industrisë kimike, (6.0%) mjetet e transportit, (5.8%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre.

⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Shtator 2012. Statistikat ekonomike: Statistikat e tregtisë së jashtme, fq. 9. Në dispozicion në: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/14-tregtia-e-jashtme/97-statistikat-e-tregetise-se-jashtme-2012.

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Tetor 2012. Statistikat ekonomike: Indeksi i Çmimeve të Konsumit, fq. 9. Në dispozicion në http://esk.rks-gov.net/cmimet/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-/96-indeksi-i-cmimit-te-konsumit-2012.

⁷ Bazuar në shportën e konsumit familjar të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, përzgjedhja e produkteve është ndarë në kategoritë në vijim: ushqim, kujdes shëndetësor, transport, komunikim, shtëpitë dhe ndërtim.

- ⁸ Gazeta Jeta në Kosovë. 5 Mars 2012. Arkat e Varfërisë. Në dispozicion në: <http://gazetajnk.com/index.php?cid=1,987,1534>.
- ⁹ Gazeta Jeta në Kosovë. 5 Mars 2012. Arkat e Varfërisë. Në dispozicion në: <http://gazetajnk.com/index.php?cid=1,987,1534>.
- ¹⁰ Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. 9 Janar 2010. Vendimi Nr. 03 datë 1.09.2010 mbi praktikën e bashkërenduar për shitjen e arkave fiskale në mes të ndërmarrjes SH.P.K „GEKOS“ dhe ndërmarrjes SH.P.K. „DUKAGJINI“. Në dispozicion në: http://ak.rks-gov.net/repository/docs/Vendim_arkat_fiskale_Gekos_Dukagjini.pdf.
- ¹¹ Përfaqësues i Odës Amerikane në Kosovë. 14 Shtator 2012. Intervistë personale.
- ¹² Kuvendi i Kosovës. 31 Gusht 2011. Ligji Nr.04/L-047 për masat mbrojtëse në importe. Në dispozicion në: <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,675>.
- ¹³ Intervistë anonime. 14 Gusht 2012. Intervistë personale.
- ¹⁴ Koha Ditore. 18 Qershor 2012. Shpërndarja e masave mbrojtëse pasi u arritën rezultate të mira në mbështetjen e prodhimit vendor.
- ¹⁵ Koha Ditore. 16 Qershor 2012. Kusari-Lila nuk tërhiqet, nuk brengoset nga vlerësimi i BE-së Në dispozicion në: <http://www.koha.net/?page=1,13,103619>.
- ¹⁶ Përfaqësues i SharrCemit. 7 Gusht 2012. Intervistë personale.
- ¹⁷ Përfaqësues i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. 19 Shtator 2012. Intervistë personale.
- ¹⁸ Përfaqësues i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. 19 Shtator 2012. Intervistë personale.
- ¹⁹ Përfaqësues i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. 19 Shtator 2012. Intervistë personale.
- ²⁰ Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Misioni. Në dispozicion në: <http://ak.rks-gov.net/?cid=1,21>.

Pse kosovarët paguajnë më shumë?

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

336.2(496.51)

Taksa e fshehur : pse kosovarët paguajnë me shumë ? /
[Përgatiten Kastriot Jahaj, Dardan Sejdiu] - Prishtinë :
Demokracia për zhvillim, 2013. - 32 f. : ilustr. me ngjyra ; 21
cm. – (Seria : Interesi Publik ;1)

1. Jahaj, Kastriot 2. Sejdiu, Dardan

ISBN 978-9951-608-09-1

Demokraci për Zhvillim (D4D) është një institut hulumtues i themeluar në vitin 2010 me besimin se demokracia është parakusht për zhvillim. Themeluesit e D4D besojnë se demokracia është mjet dhe qëllim për zhvillim dhe janë të përkushtuar që të hulumtojnë dhe të përfshijnë një komunitet më të gjerë drejt këtij qëllimi.

Misioni i D4D-së është të ndikojë në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtojë zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të përforcuar kulturën demokratike në Kosovë.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org.

European Fund for the Balkans

Bringing the Western Balkans closer to the European Union

ISBN 978-9951-608-09-1



9 789951 608091